



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 21.1.1-2012-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË ZYRËS SË KRYEMINISTRIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2012

Prishtinë, Qershor 2013

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen aditime të rregullsisë si dhe ato të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it që ka të punësuar rreth 140 anëtarë të stafit. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe që certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare për çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë aditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP në mënyrë direkte promovojnë llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti mbajtur llogaridhënës menaxherët e organizatave individuale buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Zyrës së Kryeministrit në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili ka bërë mbikëqyrjen e auditimit.

Opinionin dhe raportin i nxjerrë janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Beza Halilaj mbështetur nga Ilir Abazi (Udhëheqës i ekipit), Besa Morina dhe Shqiponja Krasniqi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	7
2 Pasqyrat vjetore financiare.....	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak	10
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	11
5 Sistemi i auditimit të brendshëm.....	30
6 Konkluzioni i përgjithshëm	32
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZAP	33
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	35

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare (PVF) për vitin 2012 për Zyrën e Kryeministrit (ZKM). Unë do të doja të falënderoja Kryeministrin dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Në kuadër të këtij auditimi përfshihen edhe agjencionet vartëse të ZKM-së, si; Agjencioni i Statistikave të Kosovës (ASK), Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës (AShAK) dhe Agjencioni për Barazi Gjinore (ABGj). Përveq kësaj, një auditim menaxherial me fokus mbi sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e brendshëm është bërë për AUV-in. Për këtë, është përgatitur një raport i veçantë i auditimit.

Ekzaminimi i PVF-ve për vitin 2012 ishte ndërmarrë në përputhje me Standardet e Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (SNASP) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat për të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me PVF-të.

Auditimi ynë fokusohet në:

- Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF);
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit); dhe
- Sistemin e Auditimit të Brendshëm.

Opinion

Auditori i Përgjithshëm (AP) i raporton Kuvendit për opinionin e tij në formatin e përcaktuar në kapitullin II.3 – Opinionin i Auditimit. Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ana e ZAP. Raporti i AP-së përfshin një opinion për vërtetësinë dhe drejtësinë e PVF-ve.

Opinionin e AP-së është:

Opinion i Pakualifikuar

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (**SNISA 400 Opinion i Pakualifikuar**)

Konkluzioni i përgjithshëm

Niveli i punës së ndërmarrë nga ana e ZAP-it për të përfunduar auditimin e vitit 2012 është pasqyrim i drejtpërdrejtë i cilësisë së mjedisit të kontrollit të brendshëm të implementuar nga menaxhmenti. Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Sistemi i kontrolleve të brendshme të ZKM-së është dizajnuar në mënyrë të duhur, por nuk ka funksionuar në mënyrë efikase dhe si duhet në të gjitha rastet.

Ne ishim në gjendje të kemi siguri në funksionimin efektiv të kontrolleve menaxheriale në një numër fushash të sistemit të kontrollit dhe menaxhimit financiar. Por, kemi identifikuar edhe disa dobësi në disa aspekte të këtij sistemi. Dobësitë janë të shpjeguara me detajisht në brendi të këtij raporti.

Në pjesën kryesore të këtij raporti, kemi diskutuar cilësinë e raportimit financiar dhe të gjeturat tona të detajuara të auditimit në lidhje me fushat në të cilat auditimi ynë ishte fokusuar.

Rekomandimet e auditimit kanë për qëllim të mbështesin menaxhmentin e ZKM-së në përmirësimin e kontrolleve financiare dhe rritjen e aspekteve tjera të aktivitetit operacional. Ne kemi konsideruar përgjigjet ndaj rekomandimeve tona të bëra në vitin 2011 - pozita aktuale është përmbledhur në Shtojcën II.

Rekomandimet tona kryesore për Kryeministrin janë si në vijim:

Përmes Sekretarit të përgjithshëm të ZKM-së të siguroj se:

Pasqyrat vjetore financiare

- Shënimet shpjeguese të PVF-ve shpalosen në pajtim me formatin dhe mënyrën e përcaktuar ligjore, në mënyrë që informatat të jenë sa me të qarta.

Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

- Plani i veprimit e përcakton qartë një afat kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarë të stafit përgjegjës të identifikuar - dhe me fokus fillestar në fushat e rëndësisë më kyqe;
- Janë vlerësuar përgjatë gjithë vitit arsyet për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit dhe ti përcaktojnë opcionet praktike për përmirësim;
- Evidencat janë të plota dhe të sakta për të hyrat e faturuara, dhe është bërë ndarje e detyrave në menaxhimin e të hyrave dhe gjetjen e mënyrës për sigurimin me kohë të dëshmive për të hyrat nga AUV;
- Mekanizmat e kontrollit janë përforcuar në menaxhimin e kontratave dhe aktiviteteve të prokurimit;

-
- Shpenzimet klasifikohen sipas kategorive dhe kodeve përkatëse ekonomike;
 - Kontrollat që kanë të bëjnë me avanset duhet të shqyrtohen dhe të ngritet niveli i tyre për të siguruar arsyetime të qendrueshme dhe kthimin e fondeve në kohën e duhur;
 - Janë shqyrtuar kontrollat ekzistuese për sa i përket subvencioneve dhe të konsideroj marrjen e veprimeve shtesë për të siguruar arritjen e qëllimeve të dakorduara me marrëveshje; dhe
 - Menaxhimi i pasurisë bëhet sipas kërkesave të udhëzimit relevant në fuqi.

Sistemi i auditimit të brendshëm

- Menaxhmenti i ZKM-së të marrë parasysh plotësimin NjAB-së me staf shtesë. Alternativa tjetër mund të jetë themelimi i NjAB-ve në AUV dhe ASK.

Përgjigje nga menaxhmenti - auditimi i vitit 2012

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe janë zotuar se do ti adresojnë rekomandimet tona

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Është përgjegjësi e ZKM-së të përgatis pasqyrat vjetore financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për "Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme". Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF-ve dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinioneve:

- Nëse PVF-të japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit ka reflektuar vlerësimin e rrezikut tonë të auditimit për ZKM-në. Ne kemi konsideruar të kuptuarit tonë për organizatën, deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale dhe nivelin e testimit të hollësishëm të kërkuar gjatë përcaktimit të testimeve të përgjithshme e që janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i përgjigjeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2011 mund të gjenden në Shtojcën II.

Ne kemi përfshirë të gjeturat e rëndësishme dhe të tjera më pak të rëndësishme, që dalin nga auditimi ynë. Për plotësinë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të 9 mujorit aty ku ishte relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të rëndësishme - Çështjet kryesore për vëmendjen e atyre që janë të ngarkuar me qeverisje dhe menaxhmenti i lartë e që mund të ketë potencial të rezultojë në një dobësi materiale në kontrollet e brendshme; dhe

Të tjera - Dobësitë e identifikuar në auditimin tonë, ku veprimi do të ofrojë potencialin për përmirësime në efikasitet dhe efektivitet të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një deklaratë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimet që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare

Rishikimi ynë i pasqyrave vjetore financiare (PVF) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në PVF. Ne gjithashtu e konsiderojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Një numër i pikëve në deklaratë kanë për qëllim të ofrojnë siguri për Qeverinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

2.1 Pajtueshmëria me kornizën raportuese

Konkluzioni i përgjithshëm

Me përjashtim të mangësive të përshkruara në nënkapitullin 2.2 Cilësia e informatave, PVF-të janë përgatitur në pajtim me kërkesat për raportim financiar - RrF. 07/2011.

Përshkrimi

PVF duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh dhe kemi konstatuar se ato janë:

- Në pajtueshmëri me RrF Nr 07/2011;
- Në pajtueshmëri me SNKSP dhe kornizën e aplikueshme ligjore në fuqi;
- Dorëzuar në MF - Thesar brenda afatit kohor me datën 31.01.2013. Ato janë përgatitur vetëm në gjuhën shqipe;
- Përgatitur në kopje fizike edhe elektronike; dhe
- Nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Çështjet e ngritura gjatë auditimit të përkohshëm në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga menaxhmenti.

2.2 Cilësia dhe saktësia e informatave të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare

Konkluzioni i përgjithshëm

Dy pasqyrat kryesore financiare prezantojnë informata të plota dhe të sakta të transaksioneve financiare vjetore. Megjithatë, mangësi janë hasur në shënime shpjeguese. Disa shpjegime nuk ishin të plota dhe nuk janë shpalosur si duhet.

Ne nuk konsiderojmë se mangësitë e identifikuar në draft llogaritë (pasqyrat) tregojnë dobësi të konsiderueshme në kontabilitet ose kontrolle të cilat mund të jenë materiale.

Përshkrimi

Ky seksion përmban informata mbi gjetjet që ndërlidhen me përgatitjen e PVF-ve. Me RRF nr. 07/2011 kërkohet që secili zë në pasqyrat primare duhet të jetë i ndërlidhur me informata relevante të dhëna në shënime dhe të komentohet me përshkrim të shumave të paraqitura në raport.

Ne kemi dhënë edhe një numër sugjerimesh për të përmirësuar shpalosjet narrative dhe për të siguruar plotësinë e informacioneve shpjeguese të kërkuara si në vijim:

Rekomandimi

1. Çështja - Mangësi informatash në shpalosjet e PVF - Prioriteti - tjetër

E gjetura	ZKM nuk kishte bërë shpalosjen e shënimeve shpjeguese të PVF-ve në pajtim me RR.F për raportimin vjetor financiar të OB-ve. Mangësitë janë hasur në shpjegimet lidhur me subvencionet dhe transferet, obligimet e pa paguara, llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet kontigjente.
Rreziku	Mangësitë e hasura në shënime shpjeguese të PVF-ve, u vështirësojnë lexuesve dhe përdoruesve të PVF-ve që të kuptojnë dhe analizojnë informatat e raportuara financiare.
Rekomandimi 1	Sekretari i Përgjithshëm, duhet të siguroj se shënime shpjeguese të PVF-ve shpalosen në pajtim me formatin dhe mënyrën e përcaktuar ligjore, në mënyrë që informatat të jenë sa më të qarta.

2.3 Opinioni i Auditimit

Opinion i Pakualifikuar

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (SNISA 400 Opinion i Pakualifikuar)

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve, pavarësisht se ishte përpiluar, nuk ishte implementuar në tërësi. Një numër i çështjeve të rëndësishme ende mbetën për tu adresuar.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2011 për ZKM-në ka rezultuar në njëmbëdhjetë (11) rekomandime kryesore. Rezultatet e testimeve tregojnë për katër (4) rekomandime të adresuara, gjashtë (6) të adresuara pjesërisht dhe një (1) rekomandim të pa adresuar.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II.

Rekomandimi

2. Çështja - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura Nga rekomandimet e vitit të kaluar, vetëm një pjesë e tyre janë adresuar, pjesa tjetër është ende në proces të adresimit. Ndërsa, rekomandimi në lidhje me avanset ende mbetet i pa adresuar.

Rreziku Mos zbatimi i plotë i disa prej rekomandimeve mund të shkaktojë përsëritjen e mangësive të njëjta si ato të vitit paraprak.

Rekomandimi 2 Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se plani i veprimit është rishikuar dhe përcakton qartë një afat kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarë të stafit përgjegjës të identifikuar - dhe me fokus fillestar në fushat e rëndësishme më kyqe.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Hyrje

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Kjo mund, për shembull, të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrollet operative të nivelit më ulët. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive.

Menaxhmenti ka ndjekur këshillën tonë, ka kryer një proces të vetëvlerësimit, i cili do të zhvillohet më tutje në të ardhmen me mbështetje nga Ministria e Financave. Prosesi fillestar i vetëvlerësimit është një zhvillim pozitiv.

Një raport i veçantë i auditimit me objektivë Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli është kryer për Agjencionin e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV). Kemi vlerësuar nëse AUV ka vepruar në pajtim me dispozitat e aplikueshme të ligjeve relevante, dokumentin e politikave të kontrollit të brendshëm të financave publike (KBFP), rregullave dhe procedurave të MFK-së.

Konkluzioni i përgjithshëm është se menaxhmenti i AUV-it ka krijuar mjedis të përshtatshëm të kontrollit dhe menaxhimit financiar. Në shumicën e fushave janë dizajnuar sisteme të kontrollit të cilat sigurojnë bazë për përdorim efektiv dhe efikas të parasë publike. Por prania e disa mangësive aktuale ngrit nevojën që aspekte të caktuara të saj të avancohen me tutje, në veçanti të planifikimi i buxhetit dhe menaxhimi i pasurisë. Menaxhmenti është përkushtuar në krijimin e një strukture efikase të kontrollit, mbikëqyrjes dhe përmbushjes së përgjegjësive me çka edhe synohet me dokumentin e politikave të KBFP-së dhe procedurave të MFK-së.

Në linjë më këtë, Kryeministri inkurajohet të siguroj se Kryeshefi i AUV-it do të adresojë rekomandimet e dala nga ky raport.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Konkluzioni i përgjithshëm

Përkundër progresit në raport me vitin e kaluar, niveli i shfrytëzimit të buxhetit duhet të ngritet. Menaxhimi dhe politikat buxhetore duhet të vazhdojnë të avancohen, në veçanti tek kategoria e investimeve kapitale. Buxheti i pa shpenzuar është tregues se organizata nuk ka arritur të implementoj projektet e synuara. Kjo tregon për nevojën e analizave dhe vlerësimeve të vazhdueshme të faktorëve që ndikojnë në nën shpenzime.

Përshkrimi

Ne kemi konsideruar burimin e fondeve buxhetore të organizatës, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrave të mbledhura. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme.

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Burimet e Fondeve:	9,785,107	11,048,101	9,125,233	7,642,190	9,483,469
Granti i Qeverisë-Buxheti	9,402,934	10,227,212	8,603,436	6,779,013	7,819,286
Të bartura nga viti paraprak ² -	0	108,033	1,656	0	0
Të hyrat vetanake ³	382,173	382,173	261,888	244,099	290,306
Donacionet vendore	0	238,243	218,695	231,420	353,131
Donacionet e Jashtme	0	92,440	39,557	387,658	1,020,746

Buxheti final në raport me atë fillestar është rritur për 1,262,994€. Rritja është ndikuar nga donacionet e jashtme e ato vendore dhe nga të hyrat e bartura nga viti paraprak, që në total arrijnë 438,716€. Pjesa tjetër e rritjes është bërë me rishikim të buxhetit dhe me vendime të Qeverisë.

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetanake të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Një pjesë e faturave të planifikuara dhe të mbledhura për Buxhetin e Kosovës në vitin aktual që është përdorur nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Në raport me vitin e kaluar kur buxheti ishte shpenzuar 76%, gjatë vitit 2012 ZKM ka shfrytëzuar 83% të buxhetit final apo 9,125,233€. Megjithëkëtë, niveli i ekzekutimit të buxhetit ende nuk është i kënaqshëm. Realizimi i ulët i buxhetit kryesisht është ndikuar nga ngecja në implementimin e projekteve kapitale.

Programi për Investime Publike përfshin disa projekte në vazhdim nga viti paprapak dhe tri të reja të vitit aktual. Projekti Ndërtimi i fabrikës së riciklimit në bashkëfinancim me Komisionin Europian nuk ishte realizuar në vitin 2012, ndërsa progresi fizik i projektit të binjakëzimit IPA (Instrumenti i Para Anëtarësimit) nuk ishte në nivelin e pritur. Ngeçjet në implementim janë evidente edhe tek disa projekte të filluara para vitit 2012. Kjo ka reflektuar në mos realizimin e buxhetit vjetor.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike-realizimi ndaj buxhetit (në euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	9,785,107	11,048,101	9,125,233	7,642,190	9,483,470
Pagat dhe Mëditjet	3,289,915	3,439,982	3,006,973	2,591,845	2,338,439
Mallrat dhe Shërbimet	2,632,394	3,504,918	2,955,591	2,543,889	3,252,328
Komunalitë	232,798	217,798	135,011	115,215	119,837
Subvencionet & Transferet	1,230,000	1,346,147	1,211,450	951,811	1,118,311
Investimet Kapitale	2,400,000	2,539,256	1,816,207	1,439,429	2,654,553

Shpjegimet për ndryshimet e kategorive buxhetore janë dhënë në vijim:

Rritja e buxhetit për Paga dhe Mëditje për 150,067€, dhe ajo e Mallrave dhe Shërbimeve për 872,524€, është reflektim i themelimit të Zyrës së Komisionerit për Gjuhët, formimit të disa komisioneve punuese, dhe për personelin e përfshirë në skemën e fondit për kuadro. Rritja e buxhetit të mallrave dhe shërbimeve ka përfshirë gjithashtu të hyrat e bartura nga viti paraprak në vlerë 108,032€ dhe 92,440€ nga donatorët e jashtëm.

Buxheti për Shërbime Komunale është zvogëluar për 15,000€. Kjo shumë u destinua për investime kapitale.

ZKM ka pranuar edhe 238,243€ grante nga donatorët e brendshëm, të cilat janë ndarë për subvencione dhe investime kapitale. Subvencionet janë dedikuar për financimin e fondit për mbështetjen e mediave minoritare multietnike dhe grupeve tjera të veçanta. Ndërsa, mjetet e ndara për investime kapitale janë dedikuar për mbështetjen e projektit - Ndërtimi

i shtëpive për kategoritë e rrezikuara të shoqërisë. Lidhur me investimet kapitale, me rishikim të buxhetit një projekt kapital i AUV-it ishte anuluar ndërsa ishte aprovuar një tjetër projekt. Edhe për AShAK-un ishte aprovuar një projekt i ri kapital.

Grantet nga donatorët e jashtëm dhe donatorët e brendshëm janë shfrytëzuar për qëllimet e dedikuara.

Tabela 3. Të hyrat e mbledhura për buxhetin e Kosovës - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Pranimet	2011 Pranimet	2010 Pranimet
Të hyrat vetanake	382,173	382,173	4,258,169	3,973,745	4,260,832
Donacionet e jashtme	-	-	87,953	338,768	546,461
Gjithsejt	382,173	382,173	4,346,122	4,312,513	4,807,293

Me buxhetin e vitit 2012, nga fondi i të hyrave vetanake, për nevojat e AUV-it dhe ASHAK-ut është lejuar të shpenzohen 382,173€. Pjesa tjetër e të hyrave të realizuara i takon Buxhetit të Kosovës (BK).

Rekomandimi

3. Çështja - Realizimi i Buxhetit - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura Ekzekutimi i buxhetit nuk ishte në nivelin e pritur, në veçanti te investimet kapitale dhe shërbimet komunale.

Në anën tjetër, kishte nën shpenzim te buxhetit për mallrat dhe shërbimet, përderisa niveli i detyrimeve të papaguara është domëthenës.

Projektet kapitale të këtij viti dhe ato të perjcellura nga viti i mëparshëm nuk ishin realizuar konform planeve buxhetore. Ngecjet në realizimin e projekteve kanë reflektuar në nënshpenzim të buxhetit.

Gjithashtu, vetëm 62% e vlerës së planifikuar është realizuar te shpenzimet komunale.

Rreziku Planifikimi jo adekuat i buxhetit si dhe ekzekutimi në nivel jo të duhur rezulton në reduktim të efektivitetit të planeve të organizatës.

Rekomandimi 3 Sekretarit i Përgjithshëm duhet ti vlerësojë përgjatë gjithë vitit arsyet për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit dhe ti përckatojë opsionet praktike për përmirësimin e nivelit të ekzekutimit. Kjo mund të përfshijë:

- Punën me organizatat tjera buxhetore për t'u munduar të ndikohet në shkaktarët e ngjashëm si psh (proceset e

prokurimit) për të promovuar procese më të ngjeshura që reduktojnë vonesat dhe mundësitë për vërejtje në proces;

- Monitorimin proaktiv të nivelit të shpenzimeve në nivelin e nën-kategorive, ndërlidhja me MF-në për t'i liruar fondet të cilat nuk pritet të përdoren; dhe
- Shqyrtimi i proceseve të planifikimit të buxhetit për t'u siguruar që ato janë të qëndrueshme.

4.3 Kërkesat e raportimit

Konkluzioni i përgjithshëm

ZKM ka përmbushur kërkesat ligjore për raportime financiare dhe operative. Të gjitha raportet e kërkuara, janë dorëzuar në MF dhe institucionet e tjera brenda afateve kohore.

Përshkrim

Përveç përgatitjes dhe raportimit të PVF-ve, ZKM ka përmbushur edhe obligimet tjera ligjore për raportim të jashtëm për vitin 2012, si atë për:

- Raportimin në lidhje me kërkesat buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Planin përfundimtar të prokurimit dhe Raportin vjetor për kontratat e nënshkruara publike;
- Raportet mbi kontrollet e brendshme, përfshirë raportin e vetë-vlerësimit;
- Raportimin mujor në MF për borxhet ndaj furnitorëve;
- Raportimet tremujore dhe atë vjetor në NjQH/AB, nga NjAB për punën dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm; dhe
- Planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.4 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

Konkluzion i përgjithshëm mbi të hyrat

Vlerësojmë se grumbullimi dhe menaxhimi i të hyrave është bërë në pajtim me kornizën ligjore në fuqi. Megjithatë, edhe me tutje mbeten disa mangësi në këtë fushë të cilat nevojitet të adresohen për përmirësim.

Përshkrimi

Vlera e përgjithshme e të hyrave vjetore të pranuar në llogarinë e vetme të thesarit është 4,346,122€. Nga to, 87,953 janë të hyra nga donatorët e jashtëm.

Tabela nr.4 Llojet e të hyrave sipas programeve

(ne euro)

Lloji i të hyrave	Programet/Agjencionet				Totali
	ZKM	ASK	ASHAK	AUV	
Taksa tjera administrative			6,820	52,311	59,131
Taksa për çertifikata mjekësore				21,410	21,410
Të hyrat nga konfiskimet				50,500	50,500
Të hyrat nga barnat e medikam.				12,323	12,323
Shitja e gazetës zyrtare	72,493				72,494
Qiraja nga objekteve publike			21,920		21,920
Të hyrat nga koncesionet	351,742				351,742
Inspektimet sanitare në kufi				5,330	5,330
Inspektimet fitosanitare në kufi				2,932,633	2,932,633
Inspektimet veterinare në kufi				730,687	730,687
Të hyrat nga grantet		87,953			87,953
Totali	424,235	87,953	28,740	3,805,194	4,346,123

Me ligjin e buxhetit për vitin 2012, nga fondi i të hyrave është lejuar që AUV të shpenzojë 345,597€, dhe ASHAK-u 36,576€, apo në total 382,173€. Këto mjete janë dedikuar të shpenzohen për paga e mëditje dhe mallra e shërbime. Shpenzimet aktuale vjetore nga fondi i të hyrave janë 263,544€. Pjesa tjetër e të hyrave prej 3,875,966€ është mbledhur për buxhetin e përgjithshëm.

Regjistrimi i të hyrave është bërë në kode përkatëse ekonomike. Harmonizimi i të hyrave është bërë në baza të rregullta mujore dhe tremujore me Thesar/MF.

Në AUV, zyret regjionale dhe zyret në pikë-kalimet kufitare kishin raportuar për aktivitetet operative në baza ditore, ndërsa raportet financiare së bashku me faturat/fletëpagesat e të hyrave i dorëzonin në baza mujore.

Raportimi financiar në baza mujore, mund të vështirësoj regjistrimin, verifikimin dhe harmonizimin e të hyrave me raportet ditore bankare. Raportimet e tilla duhet të jenë më të shpeshta, derisa të aplikohet një softuer financiar online për regjistrimin e të hyrave. Kjo do të mundësonte transmetimin e drejtpërdrejtë të informatave për të hyrat ditore të realizuara nga pikë-kalimet kufitare dhe zyret regjionale.

Lidhur me këtë, AUV në bashkëpunim me donatorët e jashtëm ishte në proces e sipër në sigurimin e një softueri financiar online, i cili do të përdorej për këtë qëllim. Realizimi i këtij projekti do ti eliminonte mangësitë e paraqitura.

ZKM, gjate vitit ka mbledhë edhe te hyra nga qeraja. Gjatë auditimit kemi vërejtur mangësi në përditesimin e informatave për sa i përket llogarive të arkëtushme. Pas keshillave tona kjo çështje është përmiresuar nga ana e ZKM-së. Nga auditimi i dokumentacionit kemi hasur mangësit e shpjeguara më poshtë.

Rekomandimi

4. Çështja - Mangësi në menaxhimin e të hyrave - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura Në AShAK, faturimi, inkasimi dhe regjistrimi i të hyrave nën 10€ bëhet nga i njëjti zyrtar. Sipas Rr.F. 03/2010, zyrtari i të hyrave nuk mund të jetë edhe mbledhës i parave publike.

ASHAK ofron hapsira me qira për institucionet e tjera publike. Evidencat rreth obligimeve të qiramarrësve nuk ishin të plota. Gjithashtu, kishte vonesa në pagesën e qirasë nga qiramarrësit.

Rreziku Evidencat e mangëta për të hyrat nga qiraja, shkakton paqartësi rreth saktësisë së obligimeve dhe pagesave të bëra nga qiramarrësit. Zhvillimi i të gjithë procesit të të hyrave nga i njëjti zyrtar është në kundërshtim me rregullat e kontrollit dhe menaxhimit financiar.

Rekomandimi 4 Sekretari i përgjithshëm përmes kryeshefit ekzekutiv të ASHAK-ut duhet të siguroj evidenca financiare të plota dhe të sakta për klientët.

Mbledhja e të hyrave të bëhet nga zyrtari përkatës siq është arkëtari i organizatës. Të shtohen masat e veprimt në mbledhjen me kohë të të hyrave nga qiraja.

4.5 Shpenzimet

Konkluzion i përgjithshëm mbi shpenzimet

Zhvillimi i mëtutjeshëm i kontrolleve është i nevojshëm në disa nga fushat që kanë të bëjnë me shpenzimet.

Përkundër përmirësimeve në menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit, edhe me tutje mbeten mangësi në këtë fushë. Mos aplikimi i kriterëve përzgjedhëse mbi gjendjen ekonomike-financiare dhe mundësive teknike e profesionale për ofertuesit ishte dukuri apo praktikë e shpeshtë. Ato nuk kërkoheshin në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit. LPP nuk e obligon këtë, megjithatë i jep mundësi autoritetit kontraktues të kërkojë nga operatorët përmbushjen e kriterëve të tilla. Kërkesa për plotësimin e këtyre kriterëve, siguron autoritetin kontraktues se ofertuesit posedojnë kualifikimet minimale për përmbushjen e kontratave publike.

ZKM duhet të marrë në konsideratë aplikimin e kriterëve të tilla përzgjedhëse, veçanërisht tek procedurat e hapura të prokurimit. Kjo do të siguronte se vetëm ofertuesit që posedojnë aftësitë profesionale, financiare dhe teknike për t'i përmbushur kushtet e kontratës përkatëse, do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë.

Mangësi janë hasur edhe në menaxhimin e kontratave. Shpenzimet nuk ishin klasifikuar në kategori dhe kode përkatëse, ndërsa kishte edhe vonesa në pagesën e obligimeve. Kontrollat lidhur subvencionet nuk ishin mjaft efikase, ndërsa kishte probleme edhe në mbylljen e avanseve për udhëtime zyrtare.

4.5.1 Prokurimi

Përshkrimi

Organizimi i procesit të prokurimit publik në kuadër të ZKM-së është i decentralizuar. Agjencionet që veprojnë në kuadër të saj, si ASK, AUV dhe ASHAK përgatisin planet e tyre vjetore, dhe zhvillojnë ndaras aktivitetet e planifikuara të prokurimit. Vlera e përgjithëshme e kontratave të nënshkruara përmes procedurave të prokurimit publik arrin në 1,189,228€.

Për të verifikuar se aktivitetet e prokurimit janë zhvilluar në përputhje me LPP dhe legjislacionin sekondar, ne testuam 22 aktivitete të prokurimit në vlerë 466,200€. Gjithashtu, ne kemi audituar pagesa në vlerë totale 1,325,620€.

Në AUV, financimet e projekteve për mbrojtjen e shëndetit publik, kontrolleve veterinarë, hulumtimeve diagnostike, vaksinimit të kafsheve etj, janë klasifikuar në investime kapitale. Natyra e shpenzimeve të tilla i takon kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.

Kjo është rezultat i mos ndarjes së buxhetit në kategorinë përkatëse ekonomike gjatë aprovimit vjetor nga ana e MF-it. AUV ka ngritur këtë çështje në instancat përkatëse dhe ka kërkuar që buxheti i planifikuar për këto projekte të ndahet në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Adresimi i kësaj çështje në të ardhmen varet nga MF.

Mangësitë e identifikuara në këtë fushë janë shpalosur në vijim.

Rekomandimet

5. Çështja - Mangësi procedurash në aktivitetet e prokurimit - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura Në dy aktivitete të prokurimit të udhëhequra nga ZKM, dhe një nga Agjencia për Barazi Gjinore (ABGj), në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit kriteret e (pranueshmërisë)⁴ për zgjedhjes ishin klasifikuar si të dëshirueshme e jo obligative. Në një rast fituesi i tenderit nuk kishte ofruar çertifikatën nga autoriteti kompetent gjyqësor.

ABGj kishte inicuar aktivitetin të prokurimit *Prezantimi i grave në mediat e shkruara 2010-2011*, pa Deklaratën e Nevojave dhe Disponueshmërisë së Mjeteve. Gjatë auditimit, për këtë aktivitet të prokurimit nuk na është ofruar dokumentacioni për auditim më kohë (dosja e tenderit e operatorit ekonomik fitues). Ky dokumentacion na është ofruar gjatë fazës përfundimtare të finalizimit të raportit.

Dy aktivitete të pa planifikuara të prokurimit ishin zhvilluar pa u njoftuar Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP). Bëhet fjalë për kontratën *Prezantimi i grave në mediat e shkruara 2010-2011*, në vlerë 4,292€ dhe kontratën *Furnizim me goma për automjetet e ZKM-së* në vlerë 18,449€.

⁴ Me legjislacionin sekondar të LPP-së kërkohet që para nënshkrimit të kontratës fituesi i tenderit duhet të dëshmojë plotësimin e kërkesave të pranueshmërisë (dëshmi nga gjykata kompetente, dëshmi mbi pagesën e tatimeve, dëshmi mbi pagimin e obligimeve ndaj ndonjë operatori të shërbimeve publike)

Rreziku

Ndonëse ofertat fituese ishin me çmim më të lirë, mos përmbushja e kërkesave ligjore të LPP-së dhe mos aplikimi i kriterëve të përshatshme, mund të rezultojë në përzgjedhjen e ofertuesve që ju mungojnë mundësitë profesionale, ekonomike dhe aftësitë teknike në përmbushjen e plotë të kontratave. Ndërsa mos dorëzimi më kohë i dokumenteve mund të krijojë hapsirë për interpretime të ndryshme në lidhje me arsyet/motivet e mosdorëzimit.

Rekomandimi 5

Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se aktivitetet e prokurimit zhvillohen konform kërkesave të LPP-së dhe legjislacionit sekondar. Komisioni i vlerësimit të tenderëve duhet të marrë parasysh përmbushjen e të gjitha kriterëve nga operatorët përzgjedhës;

Kriteret e (pranueshmërisë) përzgjedhjes së ofertave të jenë të karakterit obligues për ofertuesin e përzgjedhur; dhe

AQP të njoftohet para se të inicohen aktivitetet e prokurimit për blerjet që nuk janë përfshirë në planin final të prokurimit.

Te analizohen motivet e mosdorëzimit të dokumenteve me kohë dhe të sigurohet që në auditimet vijuese i gjithë dokumentacioni është i gatshëm për qëllime të auditimit në kohën e duhur.

6. Çështja - Menaxhimi i kontratave dhe procesi i pranimit është përcjellë me mangësi - Prioriteti - tjetër

E gjetura Në ZKM, në pesë raste plani i menaxhimit të kontratës (PMK)⁵ nuk ishte nënshkruar mes palëve kontraktuese. Departamenti i prokurimit për menaxher të kontratave kishte caktuar zyrtarin e prokurimit. Mos aplikimi i planeve të menaxhimit nga menaxherët e kontratave janë hasur edhe në AUV në katër raste, dhe në dy raste në ASK.

Po ashtu, raportet e pranimit (SIMFK) nuk ishin nënshkruar nga zyrtari për pranimin e mallrave/shërbimeve, por nga zyrtarët e njësisë kërkuese. Kjo është hasur në tri raste në ZKM dhe katër raste në ASK.

Rreziku Mos aplikimi i PMK-së, nuk siguron mbikqyrje të ekzekutimit të kontratave. Kjo vështirëson ofrimin e informatave të nevojshme dhe të mjaftueshme rreth ecuresë së implementimit të kontratave.

Rekomandimi 6 Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se është duke aplikuar procesin e mbikqyrjese se kontratave duke siguruar plane dhe menaxher përkatës të kontratës. Plani të mundësoj veprime të nevojshme dhe të mjaftueshme për monitorimin e ecuresë së implementimit të kontratës.

Raportet e pranimit të SIMFK-së plotësohen dhe nënshkruhen nga zyrtari i çertifikuar për pranim.

7. Çështja - Klasifikimi i shpenzimeve në kategori dhe kode joadekuate ekonomike - Prioriteti i rëndësishëm

E gjetura Pagesat në vlerë 118,890€ për Projektin “Vazhdimi i ndërtimit të 32 shtëpive për kategoritë e rrezikuara të shoqërisë kosovare”, ishin bërë nga kategoria e investimeve kapitale. Natyra e shpenzimit të tillë i takon Subvencioneve.

Përveç kategorive ekonomike, mangësi janë vërejtur edhe gjatë klasifikimit të shpenzimeve në kode ekonomike. Përdorimi i gabuar i kodeve është hasur në shtatë (7) raste, në ZKM dhe në të gjitha Agjencionet e saja vartëse.

⁵ Sipas nenit 81 të LPP-së, kërkohet që autoriteti kontraktues të hartojë një plan të menaxhimit të kontratës, duke përfshirë çështjet e aspekteve organizative, ekonomike, teknike dhe ligjore. Plani duhet të jetë i dakorduar dhe i nënshkruar midis palëve të kontratës para inicimit të zbatimit të saj. Menaxher i kontratës caktohet një anëtar i personelit nga njësisë kërkuese, që ka shkathtësi dhe përvojë të duhur.

Rreziku Klasifikimi i shpenzimeve në kategori dhe kode ekonomike jo përkatëse, rezulton në informata jo të plota dhe të pasakta për vlerën dhe llojin e pasurive apo investimeve të bëra gjatë vitit.

Rekomandimi 7 Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj kontrollë adekuate për të parandaluar regjistrimin e shpenzimeve në kategori dhe kode të gabuara.

8. Çështja - Mangësi në zotimin e mjeteve - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura Procedurat e zotimit të mjeteve për blerjen e pajisjes laboratorike në AUV nuk ishin bërë si duhet. Pagesa e pajisjes LC MS ishte bërë nga dy zotime me kode të ndryshme ekonomike.

Tri (3) zotime në vlerë 2,651€ ishin bërë pas pranimit të mallrave dhe shërbimeve, përkatësisht pas pranimit të faturës. Kjo është hasur në ZKM, ABGJ dhe ASHAK.

Rreziku Hyrja në obligime pa zotimin e fondeve rrit mundësinë e rrezikut që organizata të mos mund të financoj projektet për blerje.

Rekomandimi 8 Sekretari i Përgjithshëm duhet që paraprakisht të sigurojë zotimin e fondeve buxhetore, në mënyrë që projektet e planifikuara të mund të realizohen në linjë me objektivat e synuara.

9. Çështja - Vonesa në pagimin e faturave/obligimeve - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura Kemi identifikuar dhjetë (10) raste ku faturat/obligimet ndaj furnitorëve ishin paguar pas afatit kohor ligjor prej 30 ditëve. Vonesat në pagesë janë hasur në ZKM dhe në Agjencionet e saja.

Rreziku Vonesat në pagimin e faturave mund të krijojnë paqartësi për sa i përket obligimeve financiare ndaj furnitorëve. Mos pagesa e obligimeve brenda afatit ligjor krijon parakushte që buxheti vjetor të mos realizohet në kohë dhe nivelin e duhur.

Rekomandimi 9 Sekretari i Përgjithshëm duhet t'i identifikojë shkaktarët për vonesat në kryerjen e pagesave dhe marrjen e veprimeve për t'u siguruar që ato përfundohen brenda afateve kohore të pritshme.

10. Çështja - Urdhërblerja pas faturës dhe pranimit të mallrave dhe shërbimeve Prioriteti - tjetër.

E gjetura Kemi vërejtur se në dhjetë (10) raste urdhërblerjet ishin përgatitur pas pranimit të mallrave/shërbimeve dhe faturës.

Rreziku Pranimi i mallrave dhe shërbimeve para urdhërblerjes mund të rezultojë që lloji, sasia dhe cilësia e tyre të mos jetë sipas kërkesave dhe nevojave reale.

Rekomandimi 10 Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se çdo porosie për furnizim të mallrave dhe shërbimeve ti paraprijë urdhërblerja.

4.5.2 Shpenzimet tjera

Konkluzion i përgjithshëm

Testimet e mostrave të kësaj fushe kanë identifikuar raste ku avanset nuk ishin arsyetuar dhe mbyllur me kohë. Ndonëse në fillim të vitit ishin mbyllur avanse në vlerë 20,730€, një pjesë e konsiderueshme e tyre ende mbetet e pa mbyllur.

Përshkrim

Shpenzimet tjera nënkuptojnë të gjitha ato blerje të cilat për shkak të natyrës së tyre nuk kërkojnë aplikimin e procedurave të prokurimit publik. Këtu përfshihen shpenzimet e telefonisë fikse, mëditjeve për udhëtimet zyrtare, shpenzimet e reprezentacionit, ato komunale etj. Ne audituam pagesa në vlerë prej 47,036€ nga kjo kategori e shpenzimeve.

UA MSHP 2004/07, për udhëtime zyrtare dhe RrF nr. 02 e thesarit, kërkojnë që avanset për udhëtime zyrtare të mbyllen dhe shumat e pa shpenzuara të kthehen në llogarinë bankare brenda dy javësh pas kthimit nga udhëtimi. Lidhur me këtë, ne identifikuam:

Rekomandimi

11. Çështja - Avanse për udhëtime zyrtare të pa mbyllura - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura Avanset për udhëtime zyrtare jashtë vendit nuk ishin mbyllur dhe arsyetuar brenda afatit kohor ligjor. Vlera e avanseve të pa mbyllura në fund të vitit ishte 52,990€. Sipas PVF-ve, avanse të hapura rrjedhin nga viti 2009 në vlerë 3,000€, nga viti 2010 në vlerë 2,100€, dhe ato të vitit 2012 në vlerë 47,890€.

Rreziku Vonesat në mbylljen e avanseve rrisin rrezikun e mos kthimit të mjeteve borxh. Gjithashtu, kjo krijon shqetësime nese këto fonde janë shfrytëzuar në mënyrë efikase dhe për qëllimin e pritur.

Rekomandimi 11 Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se, kontrollet që kanë të bëjnë me avanset duhet të shqyrtohen dhe të ngritet niveli i tyre për të siguruar arsyetime të qendrueshme dhe kthimin e fondeve në kohën e duhur.

4.5.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Në fund të vitit 2012, ZKM përfshirë Agjensionet që veprojnë përbrenda saj, kishin 551 të punësuar, nga 622 pozita të planifikuara dhe të aprovuara me Ligjin e Buxhetit. Shpenzimet vjetore të pagave dhe mëditjeve përfshirë tatimet dhe kontributet pensionale ishin 3,006,974€, apo 87% të buxhetit të planifikuar për këtë kategori.

Ne 35 mostra të përzgjedhura kemi testuar; aktivitetet e rekrutimit, llogaritjen e pagave, kontratat, pushimet e lehonisë dhe ato pa pagesë, vlerësimin vjetor të performancës, dhe mirëmbajtjen e dosjeve të personelit. Nga testimi i mostrave nuk është evidentuar ndonjë mangësi për tu theksuar.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.5.4 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Mjetet e shpenzuara për subvencione ishin 1,211,450€, apo 90% e ndarjes buxhetore të kësaj kategorie. Pjesa më e madhe e subvencioneve është dhënë për entitetet jo publike. Përfitues të subvencioneve ishin edhe entitetet publike dhe përfituesit individual.

Ne testuam njëzet (20) pagesa për subvencionet në vlerë 362,065€. Kemi vërejtur se mbikqyrja dhe financimi i projekteve është përcjellë me mangësi, të shpalosura në vijim.

Rekomandimi

12. Çështja - Mungesë kontrolli dhe raporte financiare të mangëta nga përfituesit e subvencioneve - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura Në marrëveshjen në mes ABGj-së dhe përfituesve të subvencioneve, nga këta të fundit ishte kërkuar dorëzimi i raporteve financiare të mbështetura me fatura origjinale. Në dy raste në ABGJ, përfituesit e subvencioneve nuk kishin dëshmuar si duhet shpenzimet e ndodhura. Një pjesë e tyre nuk ishin arsyetuar me fatura dhe dëshmi mbështetëse, psh: mungonin disa fatura për materialin shpenzues, etj. Bëhet fjalë për projektin *Pushimi i lehonisë, ligji i ri i punës, dhe punësimi i femrave në tregun e punës* në vlerë 9,000€, dhe projektin *Përmirësimi i çështjes gjinore në familjet rurale* në vlerë 8,500€.

Mangësi të kësaj fushe janë hasur edhe në ZKM. Në dy raste përfituesit (OJQ-ve) nuk kishin raportuar për ecurinë dhe progresin e realizimit të projekteve.

Dështimi në përmbushjen e marrëveshjeve të përcaktuara për dhënien e subvencioneve rritë rrezikun që subvencionet e paguara të mos arrijnë qëllimet e synuara.

Rekomandimi 12 Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se janë shqyrtuar kontrollet ekzistuese për sa i përket subvencioneve dhe të konsideroj marrjen e veprimeve shtesë për të siguruar arritjen e qëllimeve të dakorduara me marrëveshje. Kjo mund të përfshijë; nxitjen për raportim të vazhdueshëm në lidhje me ecurinë dhe progresin e arritur në implementimin e tyre.

4.6 Pasuritë

Konkluzioni i përgjithshëm mbi pasuritë

Me gjithë ndryshimet pozitive, menaxhmenti nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur regjistrimit dhe menaxhimit të pasurisë. Aplikimi i sistemit të menaxhimit të pasurisë e-pasuria është përcjellë me disa vështirësi në përdorim. Shënimet ekzistuese ende nuk mund të konsiderohen të plota dhe të sakta për vlerën dhe sasinë e pasurisë në disponim.

4.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Për qëllime të regjistrimit të pasurisë ZKM përdorë regjistrin kontabël të thesarit/SIMFK dhe sistemin e menaxhimit të pasurisë e-pasuria.

Vlera neto e pasurisë kapitale të ZKM-së dhe Agjencioneve sipas regjistrimit kontabël është 3,286,561€. Ndërsa, pasuria jo-kapitale vlerësohet të jetë 725,899€, dhe stoqet e materialit shpenzues 270,220€. Regjistrimi dhe menaxhimi i pasurisë nga agjencionet bëhet ndaras.

Në fund të vitit ishte bërë vlerësimi dhe numërimi fizik/inventarizimi i pasurisë në ZKM dhe në agjencionet ekzekutive.

Megjithatë, kemi vërejtur disa mangësi në regjistrimin dhe menaxhimin e pasurisë në sistemin e pasurisë, të cilat janë shpalosur në vijim:

Rekomandimi

13. Çështja - Mangësi në regjistrimin dhe menaxhimin e pasurisë - Prioriteti - i rëndësishëm.

E gjetura Regjistrat e pasurisë jo-kapitale dhe stoqeve të ASK-së dhe ASHAK-ut nuk ishin të plota dhe të sakta. Në sistemin “e_pasuria” janë evidentuar raste ku pasuritë ishin me vlera negative. Zyrtari i pasurisë në ASK nuk kishte qasje në modulën e pasurisë kapitale. Si rezultat, kjo pasuri nuk ishte klasifikuar në kategorinë e duhur. Në AUV aplikacioni “e_pasuria” nuk përdorej si rezultat i problemeve teknike. Në ZKM, vlera e pasurisë kapitale në sistemin “e-pasuria” ndryshonte nga ajo e regjistrit kontabël të thesarit. Në pamundësi të qasjes në sistemin elektronik të e-pasurisë, ne nuk patëm informata të sakta as për pasurinë e ABGj-së.

Mangësi janë hasur edhe në listat e numërimit fizik/inventarizimit të pasurisë. ABGj nuk kishte arritë të evidentojë tërë pasurinë gjatë inventarizimit. Si rezultat evidencat ishin të mangëta. Edhe listë ngarkesat e pasurisë për punonjësit e ZKM-së, ASK-së dhe ASHAK-ut nuk ishin të sakta. Kishte edhe raste ku pajisjeve u mungonin shenjat identifikuese/barkodet.

Rreziku Mungesa e informatave të sakta dhe të plota për pasuritë pamundëson menaxhimin efektiv të tyre. Kjo mund të rezultojë në humbjen apo keqpërdorimin e tyre.

Rekomandimi 13 Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se regjistrat e pasurisë janë përditësuar me informata të sakta dhe të plota, duke u klasifikuar në kategoritë përkatëse. Aty ku kërkohet, të konsiderohet aplikimi i normave vjetore të zhvlerësimit.

Komisionet e inventarizimit të pasurisë të punojnë për të evituar mangësitë e paraqitura dhe të sigurohet identifikimi i vazhdueshëm i pasurisë përmes barkodeve.

Agjencionet duhet t’u sigurojnë zyrtarëve të pasurisë trajnimet e nevojshme rreth përdorimit të sistemit elektronik të menaxhimit të pasurisë *e-pasuria*.

4.6.2 Menaxhimi i automjeteve zyrtare

Përshkrim

Njësia e transportit ka bërë menaxhimin e automjeteve zyrtare, ka mbajtur shënime për shpenzimet e derivateve, riparimeve dhe kilometrave të kaluara për secilin automjet zyrtar. Megjithatë, në dosjen e një automjeti kemi hasur mangësi informatash rreth menaxhimit dhe përdorimit të saj.

Rekomandimi

14. Çështja - Kontrole jo të mjaftueshme të menaxhimit të automjeteve zyrtare - Prioriteti - tjetër

E gjetura Në dosjen e një automjeti kemi vërejtur se në disa raste kërkesat për udhëtim zyrtar nuk ishin plotësuar si duhet. Informatat e dhëna në kërkesën për shërbime të vozitjes ishin të mangëta.

Rreziku Mungesa e informatave të nevojshme dhe shfrytëzimi i automjetit pa aprovimin e zyrtarit përgjegjës, do të krijonte mundësi që automjetet të përdorën për qëllime jo zyrtare.

Rekomandimi 14 Sekretari i Përgjithshëm do të rishikoj proceset e kontrollit dhe mbikqyrjes për sa i përket përdorimit të automjeteve për të siguruar se ato përdorën në mënyrë efikase dhe efektive.

4.6.3 Trajtimi i parasë së gatshme

Përshkrimi

Paraja e gatshme është fond i vogël i parave që shfrytëzohet për të mbuluar shpenzimet dhe blerjet e vogla dhe të pa parashikueshme, vlera e të cilave nuk tejkalon shumën 100€. Auditimi i shpenzimeve të financuara nga fondi i parasë së imët, ka shpalosur:

Rekomandimi

15. Çështja - Shpenzimi i parasë së imët pa kërkesa të aprovuara - Prioriteti - tjetër

E gjetura Arkivat ndërkomunale kishin realizuar pagesa nga fondi i parasë së imët pa aprovimin paraprak nga departamenti i administratës qendrore. Lëndëve në disa raste u mungonin edhe faturat e rregullta.

Blerje nga fondi i parasë së imët pa kërkesa të aprovuara nga sektori përkatës janë hasur edhe në ZKM.

Rreziku Shfrytëzimi i parasë së gatshme pa aprovim nga niveli përkatës, krijon mundësinë që fondet të mos shfrytëzohen për nevojat e organizatës.

Rekomandimi 15 Sekretari i Përgjithshëm do të siguroj se paraja e gatshme shfrytëzohet vetëm për nevojat e paparashikuara, duke i paraprirë një proces formal i aprovimit për arsyeshmërinë e shpenzimit.

4.7 Trajtimi i borxheve

Konkluzioni i përgjithshëm mbi trajtimin e borxheve

Këtë vit vlera e obligimeve ndaj furnitorëve është përgjysmë me e vogël në krahasim me vitin e kaluar. Përkundër këtij progresi, për ZKM-në ende mbetet sfida çështja e borxheve të pa paguara. Vlera aktuale e tyre ende mund të konsiderohet e lartë. Në lidhje me këtë nevojiten kontrolle shtesë për të përmirësuar procesin e pagesave ndaj furnitorëve.

Përshkrim

Detyrimet e papaguara të ZKM-së dhe agjencioneve vartëse të prezantuara në PVF janë 104,800€⁶. Një pjesë e këtyre obligimeve në vlerë 5,303€ të cilat nuk janë paguar me kohë i takojnë muajit janar 2013.

Këto detyrime pritet të paguhen në vitin 2013. Pjesa më e madhe e faturave të pa paguara u përket muajve të fundit të vitit.

Përbërja e këtyre borxheve rrjedh nga; shpenzimet e reprezentacionit, publikimeve, derivateve, shpenzimeve komunale etj.

Mangësitë e identifikuara në këtë fushë janë prezantuar në vijim:

⁶ Prej tyre, 73,612€ i takojnë ZKM-së, 12,915€ AUV-it, 9,213€ ASHAK-ut, 5,016€ ABGJ-së, 2,589€ ASK-ës dhe 1,454€ SKSK-së.

Rekomandimi

16. Çështja - Borxhet e papaguara - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura Obligimet ishin krijuar pa u siguruar paraprakisht mjetet e nevojshme financiare. Si pasojë, obligimet ndaj furnitorëve kishin mbetur të pa kryera. Më tutje, në PVF obligimet nuk ishin shpalosur sipas kërkesave ligjore për raportim. Kjo ngase, në obligimet e vitit aktual ishin përfshirë edhe ato të vitit vijues. Nuk është prezantuar lloji i shpenzimit dhe nuk ishte dhënë arsyeja e mos pagesës së borxheve.

Rreziku Hyrja në obligime pa sigurim të fondeve, mund të rezultoj në pamundësinë e pagesës së tyre. Kjo mund të sjellë edhe konteste gjyqësore që përcillen me ndëshkime e si pasojë mund të shpenzohën fonde me tepër se kundërvlera e blerjëve të realizuara. Shpjegimet e mangëta rreth faturave të papaguara, shkaktojnë paqartësi për lexuesit e PVF-ve për informatat e prezantuara.

Rekomandimi 16 Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se janë identifikuar qartë shkaktarët që kanë rezultuar me detyrime të papaguara dhe të marrë masat e duhura për parandalimin e tyre.

Prezantimi i borxheve në PVF të bëhet në pajtueshmëri me RR.F për raportimin vjetor financiar. Obligimet vjetore të përfshijnë vetëm faturat e papaguara të periudhës aktuale.

5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Konkluzion i përgjithshëm mbi sistemin e auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) ka përmbushur në tërësi funksionin dhe objektivat e saj. Plani vjetor ishte realizuar sipas parashikimeve. Fushëveprimi i auditimit ishin aktivitetet e vitit 2012. Komiteti i Auditimit dhe NjAB kanë vlerësuar dhe siguruar informata për menaxhmentin e lartë lidhur me përshtatshmërinë dhe efikasitetin e kontrolleve ekzistuese. Sidoqoftë, marrë parasysh madhësinë e kësaj organizate me agjensionet vartëse është e nevojshme konsiderimi i gjetjes se formave për rritjen e kapaciteteve njerëzore për auditim.

Përshkrimi

Pjesë e strukturës organizative e ZKM-së, është edhe NjAB. Kjo njësi udhëhiqet dhe përbëhet vetëm nga drejtori i saj. NJAB ka përgaditur planin strategjik dhe atë vjetor. Me

planin vjetor ishin planifikuar katër (4) auditime të përgjithshme⁷, përfshirë ZKM-në, AUV-in, ASHAK-un dhe ABGJ-në. NJAB ka arritur të kryej tërë auditimet e planifikuara. Në raportet e auditimit janë prezantuar mangësi në fusha të caktuara, për të cilat janë dhënë konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse.

Çështjet e ngritura në raporte janë shqyrtuar edhe nga Komiteti i Auditimit. NjAB kishte përgatitur edhe raportet tremujore, të cilat ishin raportuar tek niveli i lartë menaxherial i ZKM-së dhe NjQH/AB të MF-it.

Rekomandimi

17. Çështja - Mos plotësimi i NjAB-së me personel të mjaftueshëm - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura ZKM nuk ka plotësuar NjAB-në me numrin e mjaftueshëm të personelit. Struktura organizative e NjAB-së nuk është organizuar në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 3 të UA 23/2009, për themelimin dhe funksionimin e NjAB-ve në sektorin publik.

Rreziku Mungesa e numrit të mjaftueshëm të auditorëve të brendshëm mund të ndikoj që funksioni i auditimit të brendshëm mbi ZKM-në dhe agjensionet vartëse të mos mund të shtrihet sa duhet.

Rekomandimi 17 Sekretari i Përgjithshëm duhet të konsideroj se NjAB është plotësuar me staf shtesë. Alternativë tjetër, mund të jetë themelimi i NjAB-ve në agjencionet (AUV dhe ASK) që karakterizohen me fushëveprim, organizim dhe madhësi buxhetore më të lartë.

⁷ Fushat nën auditim përfshijnë: menaxhimin e buxhetit/shpenzimet, të hyrat, blerjet përmes prokurimit publik, menaxhimin e personelit, menaxhimin e pasurisë dhe shfrytëzimin e automjeteve zyrtare.

6 Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni ynë i përgjithshëm e pasqyron rishikimin tonë të kontrolleve të ndërlidhura me PVF-të, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Sistemin e Auditimit të Brendshëm. Kjo mund të përmblihdhet si:

Menaxhmenti i ZKM-së ka dizajnuar mirë sistemin e kontrollit dhe menaxhimin financiar, por ato nuk kanë funksionuar në të gjitha rastet në mënyrë efektive. Përkundër strukturës komplekse të saj, ZKM dhe Agjencionet e saj vartëse kishin krijuar linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë e duhura.

PVF-të e ZKM-së, janë në pajtueshmëri me kornizën e aplikueshme ligjore. Cilësia e informatave financiare është e mirë. Janë pëmbushur edhe kërkesat tjera ligjore për raportime financiare dhe operative.

Pavarësisht progresit në zbatimin e një plani të veprimit nga ZKM për t'i adresuar rekomandimet e 2011 - një numër i tyre mbetet ende për t'u adresuar.

ZKM ka ndërtuar një strukturë të mirë të qeverisjes, por prania e disa mangësive aktuale ngrit nevojën që menaxhmenti të ketë në fokus të vazhdueshëm avancimin e sajë. Kjo ngase, buxheti vjetor nuk është shfrytëzuar në nivelin e pritur, edhe pse politikat buxhetore të këtij viti duket të jenë më efikase. Kontrollat mbi menaxhimin e të hyrave nevojitet të përforcohen.

Aktivitetet e prokurimit dhe menaxhimi i kontratave ishte përcjellë me disa mangësi. Rastet e klasifikimit të gabuar të shpenzimeve janë evidente edhe në këtë vit. Në anën tjetër, parregullësi janë hasur edhe në menaxhimin e subvencioneve. Kontrollat e pritshme nuk kishin funksionuar si duhet në menaxhimin dhe mbylljen e avanseve. Më tutje, edhe regjistrimi dhe menaxhimi i pasurisë ishte përcjellë me vështirësi.

Dobësitë e kontrollit të brendshëm janë identifikuar nga Auditimi i Brendshëm dhe janë marrë parasysh nga Komiteti i Auditimit si çështje për të vepruar. Sidoqoftë, ky sektor i rëndësishëm për organizatën nevojitet të përforcohet me kapacitete të duhura.

Menaxhmenti i ZKM-së, ka treguar një përkushtim të vazhdueshëm për të përmirësuar mangësitë e sistemit dhe për të avancuar në një menaxhim të shëndosh financiar. Kjo kërkohet edhe me kornizën e KBFP-së dhe procedurat e MFK-së.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinionit i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinionit i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionit që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinionit i Kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinionit i kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinionin në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
3. Adresimi i rekomandimeve.	Sekretari i Përgjithshëm ndërmerr veprime shtesë për t'i kushtuar më shumë vëmendje adresimit të tyre	Është përgatitur plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve.	Janë marrë masa veprimi.	
4. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit.	Planifikim të buxhetit në pajtueshmëri me nevojat dhe kërkesat. Bëhen rishikime mujore të shpenzimeve aktuale ndaj atyre të planifikuara.		Niveli i shfrytëzimit të buxhetit këtë vit është më i lartë se vitin e kaluar.	
5. Pasqyrat vjetore financiare.	Shpenzimet e evidentuara të jenë në përputhje me kodet ekonomike adekuate. Llogaritë e arkëtueshme të prezantohen në PVF.	Është bërë prezantimi i llogarive të arkëtueshme në PVF.	AUV ka bërë kërkesë në MF që buxheti të alokohet në kategorinë e mallrave e shërbimeve.	
6.1 Të Hyrat.	Merren veprime në inkasimin e borxheve/të hyrave nga qiraja (INA)	Është adresuar rekomandimi.		
6.2.2 Prokurimi.	Blerjet përmes prokurimit i paraprinë kërkesa nga njësia kërkuese. Pagesa e faturave bëhet brenda afatit ligjor prej 30 ditëve. Përzgjedhja e ofertave bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara dhe se pagesat janë konform shërbimeve	Njësit kërkuese kanë bërë kërkesat për blerjet përmes prokurimit. Pagesat janë konform shërbimeve të pranura	Mangësi janë hasur në përzgjedhjen e ofertave dhe mos pagesën me kohë të faturave.	

6.2.3. Blerjet tjera/ Avanset.	Mbyllja e avanseve për udhëtime zyrtare të bëhet brenda 15 ditëve pas kthimit nga udhëtimi.			Rekomandim i pa adresuar.
6.2.4. Subvencionet dhe transferet.	Zhvillohen procedura të qarta që përcaktojnë mënyra dhe kriteret matëse të dhënies së subvencioneve. Shtohen masat e kontrollit lidhur me shfrytëzimin dhe raportimin e realizimit të projekteve të subvencionuara.	ABGJ ka hartuar një UA për trajtimin e subvencioneve.	Dobësit në kontrollin dhe raportimin mbi realizimin e projektit ende janë prezente.	
6.3 Pasuritë.	AUV bënë inventarizimin e pasurisë në fundvit. Pasuria të identifikohet me barkode.	AUV ka bërë inventarizimin e pasurisë. Pasuria është identifikuar me barkode.		
6.4 Borxhet.	Krijohen parakushtet për monitorim më të mirë të fondeve të përcaktuara për shpenzime.		Niveli i borxheve këtë vit është përgjysmuar në krahasim me vitin paraprak.	
7.1 Sistemi i kontrollit të brendshëm.	Përpyqje të shtuara për përmirësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në fushat në të cilat janë vërejtur mangësi.		Janë evidente përmirësimet në disa nga fushat ku janë vërejtur mangësit.	
7.2 Auditimi i brendshëm.	KA dhe NJAB të përgatisin statutin e punës. KA mban takime më të shpeshta. Përgatitet plani i veprimit për implemnetimin e rekomandimeve të dhëna nga NjAB.	KA dhe NjAB kanë hartuar statutin e tyre. KA ka mbajtur takime të rregullta pune. Është përgatitur plani i veprimit		